

# AKT - THEMELIMI

## I

### SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZURA “ ONTRACK” shpk

Sot me date 12.02.2020, bazuar ne vullnetin e lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregetarët dhe shoqerite tregtare” dhe te Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Rregjistrimin e Biznesit”, i perditësuar, ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ONTRACK” shpk vendosi te hartoje aktin themelues te saj si vijon:

#### FORMIMI

##### NENI 1

Formohet shoqeria tregtare e emertuar “ONTRACK” shpk me themelues:

- 1- Z. Dritan Mukai biri i Rexhep dhe i Refije, i datelindjes 20-02-1973, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane.

#### SELIA E SHOQERISE

##### NENI 2

- 1- Selia e shoqerise tregtare private “ONTRACK” shpk, do te jete ne adresen:

**Rruga, Autostrada Tirane- Durres km 0 , brenda ambjenteve te Qendres Tregtare “ Casa Italia” (Mega-Outlet), njesia administrative Kashar.**

Ajo mund te cele edhe adresa sekondare te tjera , perfaqesime dhe agjensi operative ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit. Te gjitha keto me vendim te ortakut themelues te saj.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

##### NENI 3

#### Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Ushtrim i veprimtarise se agjentit te transferimit te parave i subjektit financiar jo banke. Agjent imobiliar. Ushtrim i veprimtarise se ndermjetesimit se agjensise se udhetimeve. Shitje kartash rimbushese. Kembim valutor. Agjent i shoqerise EasyPya shpk (Institucion i Parase Elektronike) per kryerjen e sherbimeve qe perfshijne por nuk kufizohen ne pagesa faturash, shitje te mallrave/sherbime te partenerve te EasyPya, rimbushje elektronike. Agjensi udhetimi, bileta etj.



#### NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hap objekte si; njesi sherbimi dhe tregetimi dhe do te bashkepuoje me persona fizik dhe juridik vendas dhe te huaj.

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar. Shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkak.

#### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke, dhe zotërohet si me poshte:

- **Dritan MUKA i datelindjes 20-02-1973** zoteron 100% te kuotave. **Kapitali eshte me 1 kuote vlera e te cilit eshte 100.000 leke.**

- Kapitali eshte me 1 kuote te vetme ne vleren **100, 000 leke**. Kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

#### NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

#### NENI 8

Ortaku mund t'u shese te treteve kuotat e kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi t'ua kete ofruar per blerje ortakut brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe i'u ofrohen te treteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakeve te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

#### NENI 9


Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje " **ONTRACK**" sh.p.k.

#### NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

*-Ortaku i vetem eshte dhe administratori* i Shoqerise do jete **Z. Dritan MUKA** per 5 vjet.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.



#### NENI 11

- 1- Administrator i shoqerise ONTRACK sh.p.k eshte **Z. Dritan Mukai biri i Rexhep dhe i Refije, i datelindjes 20-02-1973, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane.**

#### NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

#### NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim Ortakut te vetem ne perpjestim me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore.

#### NENI 14

Ky akt u perpilua ne prani te ortakut te vetem duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire. Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, zyren noteriale, tatim -taksa dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

**THEMELUESI I SHOQERISE "ONTRACK" shpk**

**Dritan MUKA**

